

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. FATOS QATO

12/17/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 14.12.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Fatos Qato, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 17.12.2018 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Fatos Qato, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Valbona Sanxhaktari, znj. Brunilda Bekteshi relatores, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.